

Nr. _____ Prot.

Data ____/____/2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shoqërimi i vlerave monetare per Drejtorine Rajonale Kukes
per nje periudhe 2 vjecare”.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):Shërbime
te sigurimit (roje) 79713000-5

VLERA E FONDIT LIMIT: 9,208,535.04 Leke (nente milion e dyqind e tete mije e peseqind e tridhjetë e pesë pike zero kater) leke pa TVSH.

Numri i referencës së procedurës : REF-73537-12-30-2025

Ndarje ne Lote - NUK KA

Në bazë,të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale Kukes e OSSH Sh.A, ka argumentuar mosndarjen e procedurës në lote, me përmbajtjen si më poshtë:

Referuar **Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin Publik”, neni 2 parashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, **Neni 42, pikat 1 dhe 2** të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Referuar **Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin Publik”, neni 14, Operatorët ekonomikë, parashikohet shprehimisht se:

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.
2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i

kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose

kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Në **VKM Nr. 285, datë 19.05.2021** i ndryshuar “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Theksojmë se ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak pasi ndikon drejtpërdrejt në nivelin e pjesëmarrjes së

operatorëve ekonomike në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, pra, gëzojnë në një farë mënyre të drejtën e prodhimit, apo distribucionit.

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësiave duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës, ndërkohë që në thelb shërbimi është i së njëjtës natyrë. Në këto kushte, gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me legjislacionin e sipërpërmendur.

Legjislacioni me ndryshimet e fundit që ka pësuar ka hequr nevojën për kontratë noteriale por vetëm paraqitjen e një kontratë bashkëpunimi ndërmjet operatorëve ekonomik. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik e njeh të drejtën e shoqërive për t'u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Pra duke parë natyrën, specifikat dhe përmasën e këtij shërbimi, mënyrën e funksionimit të Drejtorisë Rajonale Kukes e OSSH Sh.A, ku ky shërbim menaxhohet nga një strukturë e veçantë e specializuar prane kësaj drejtorie, do të përbënte një kosto të shtuar për institucionin tonë në ngritjen e strukturave të tjera, ç'ka do ta bënte të pamundur monitorimin e këtij shërbimi pasi do t'i shtoheshin kosto institucionit tonë ndarja në lote.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktor, vendosi të mos e ndajë në lote këtë procedurë prokurimi, pasi nëse një operator e fiton të gjithë kontratën, bazuar në parimin e ekonomisë së shkallës do mund të japi një ofertë ekonomike më të ulët dhe do mund të kursejmë të ardhura publike më shumë.

Për problemet që mund të lindin eventualisht gjatë zbatimit të kontratës, AK do i duhej të zgjidhte mosmarrëveshjet me dy ose më shumë operatorë dhe kjo mund ta vështirësonte zbatimin e kontratës.

Ka shumë vite që kjo procedurë realizohet e pa ndarë në lote, me të njëjtat institucione dhe vendroje që janë edhe këtë vit dhe shërbimet janë kryer me sukses, pa asnjë problem.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **OSSH Kukes**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **DREJTORIA RAJONALE E OSSH Kukes**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Liçensë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit të “*Shërbimit të ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike*”, **nënkategoria 1.3.B**, “*Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike dhe transport vlerash monetare*”, lëshuar nga QKL/QKB;
2. Çertifikatë e drejtuesit teknik të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për nënkategorinë **1.3.B**;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ligji nr.75/2014 date 10.07.2014 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike” neni 7, Udhezimi nr. Nr. 130, datë 5.3.2018 “Per funksionimin e shërbimit privat te sigurise” pika, 3/b

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Ky kriter shërben për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet profesionale për të zbatuar kontratën.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros te dy viteve te fundit (2023, 2024), ku vlera e xhiros ne te paktën njerin prej tre viteve, te jete jo me e vogel se 20% të fondit total limit.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kriteri duhet të plotësohet nga sejcili prej anëtarëve pjesëmarrës në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në të kundërt përbën kusht s'kualifikimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

- 2.2.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2025** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 10 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi: Në lidhje me kriterin për shlyerjen e taksave vendore, njësia e prokurimit vendosi që t’u kërkoj operatorëve ekonomik të paraqesin vërtetim për shlyerjen e taksave për vitin 2025, për të vërtetuar se kanë paguar të gjitha detyrimet ligjore lëshuar nga njësia vendore ku ato kanë ushtruar apo ushtrojnë aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR-ja, gjithçka për t’i shërbyer njohjes të operatorit ekonomik në lidhje me besueshmërinë dhe korrektësinë që ka ai ndaj zbatueshmërisë së detyrimeve ligjore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Shëbime të ngjashme:

- Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme kat. (1.3.B) në një vlerë jo më të vogël se 20% e fondit i Marrëveshjes Kuadër, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Si dëshmi për përvojën e mëparshme operatorët duhet të paraqesin Kontrat/ kontrata të përfunduara, shoqëruar me Vërtetimin e realizimit me sukses lëshuar nga autoriteti përkatës kontraktor, i cili duhet të përmbajë, Afatin, Vlerën, Objektin. Në rast se kontrata është realizuar si bashkim operatorësh, operatori duhet të paraqesë detyruesisht edhe akt-marrëveshjen e bashkëpunimit dhe prokurën e posaçme ku përcaktohet përqindja e shërbimit për secilin operator ekonomik.

Ose

-Në rastet kur shërbimet janë kryer me subjekte private duhet të paraqiten faturat tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rast se kontrata është realizuar si bashkim operatorësh, operatori duhet të paraqesë detyruesisht edhe akt-marrëveshjen e bashkëpunimit dhe prokurën e posaçme ku përcaktohet përqindja e shërbimit për secilin operator ekonomik.

Mosplotësimi i këtij kriteri me të gjithë elementët e kërkuar me sipër përbën kusht për s'kualifikim. Gjithashtu paraqitja e kontratave që janë ende në proces realizimi nuk do të quhen të vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Akt - Miratim për Qendrën e kontrollit në Qarkun Kukës të vlefshme, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Kukës në përputhje me Udhezimin e Ministrit të Brendshëm Nr.130, datë 05.03.2018 “*Per Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike*”.

Per kete duhet te paraqese **vertetim nga Drejtoria e Policise se Qarkut Kukës** ku jepet informacioni i mesiperm i kerkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, germa “a” e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligji nr. 75/2014 “Per shërbimin Privat të sigurisë fizike” si dhe Udhezimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, datë 05.03.2018 “Per funksionimin e shërbimit privat të sigurisë”.

2.3.3 Operatori duhet te paraqese Performance per nenkatgorine 1.3.B, te lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Kukës, jo me pare se muaji Tetor 2025, me ane te cilit te vertetohet:

- Disponon Qender Kontrolli ne qendren e Qarkut Kukës;
- Operator te Qendres se Kontrollit jo me pak se 3 punonjes
- Disponon minimalisht 6 punonjes shërbimi;
- Jo më pak se **1** përgjegjës shërbimi,
- Jo më pak se **1** grup të gatshëm ,
- Jo me pak se **3(tre)** armë krah,

Nuk duhet te kete marre masa administrative per operatorin ekonomik (Subjektin), Titullarin e Subjektit dhe Drejtuesin Teknik, sipas percaktimeve te kreut V, te Ligjit nr.75/2014. i ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, germa “b” e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Në lidhje me kërkesën për lëshimin e vërtetimit jo më parë se muaji Tetor 2025, AK argumenton se ky kriter është i mbështetur ligjërisht në Udhëzimin Nr. 130, datë 05.03.2018 “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, Kreu V, gërma “B”, pika 11, e cila citon: “Vlerësimi i performancës për veprimtarinë e SHPSF-së bëhet nga drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë mbi bazën e kriterëve të përmbushjes së detyrës dhe konstatimeve për shkeljet administrative. Një kopje e vlerësimit të performancës dërgohet në Drejtorinë e Rendit Publik dhe një kopje u jepet subjekteve të SHPSFve, kur kërkohet nga ana e tyre”.

Referuar dispozitës së sipërcituar, vlerësimi i performancës mund të merret në çdo kohë nga operatori ekonomik, nuk ka afat dhe merret pa asnjë pengesë.

Ky vërtetim merret brenda 10 ditëve nga momenti i aplikimit në portalin e e-albania.

Për aq kohë sa ligji nuk parashikon ndonjë afat dhe ky vërtetim mund të merret në një kohë fare të shkurtër, AK ka caktuar si afat muajin tetor 2025 duke ju lene kohen e mjaftueshme Operatoreve Ekonomik te interesuar per paisjen me kete vertetim. Gjithashtu, ky afat kohor eshte vendosur për arsye që vërtetimi të jetë sa ma i perditeluar.

.....

2.3.4 Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për muajt e fundit (Tetor – Nentor 2025) , shoqëruar me **listë pagesat e sigurimeve shoqërore** (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 6 të siguruar në muaj.

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 10 te DST-ve.

Ne rast se operatori shpallet fitues, perpara lidhjes se kontrates duhet te dorezoj dokumentat provuese per vetedekarimet qe ka bere ne formularin permbledhes te vetedeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: Duke marrë në konsideratë objektet nga ku do të transportohen vlerat, oraret/turnet, ditet e punës dhe distancën e përshkruar nga automjetet.

2.3.5 Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorimin e frekuencave për radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP në zbatim të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me zonë mbulimi Qarkun Kukës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, germa “ç” e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike që mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur me sukses kontratën.

Në lidhje me kërkesën e Autoritetin Kontraktor, që operatori ekonomik duhet të zotërojë Licensë/ Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit dhe radioalarmit të lëshuar nga **AKEP**, me zonë mbulimi **Qarkun Kukës**, kjo kërkesë bëhet duke iu referuar yendodhjes së objekteve dhe periudhës kohore për të cilat kërkohen shërbimi, kërkesa këto në përputhje me legjislacionin në fuqi, Udhëzimin Nr.130, datë 05.03.2018 “Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” Kreun VII “Uniforma, Mjetet, Pajisjet e Shërbimit, Dokumenti i Identifikimit të Punonjësit të SHPSF-së”, germa D “Qendra e kontrollit” pika 4, në të cilin përcaktohet se: “4. Subjekti i shërbimit privat të sigurisë fizike që ka në ruajtje objekte me sisteme elektronike, duhet pajiset nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) me autorizim individual.”, por dhe në proporcion të plotë me nevojat për realizimin e objektit të kontratës.

2.3.6 Ofertuesi duhet të disponojë së paku 1 **(nje) automjet** për kryerjen e shërbimit, në pronësi të shoqërisë apo të marre me qera. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Për automjetin në pronësi duhet të paraqiten:

- Çertifikatat e Pronësisë
- Lejet e qarkullimit.
- Çertifikatë e kontrollit Teknik
- Taksat e paguara.
- Siguracionet

Për automjetin me qera duhet të paraqiten:

- Kontratë qeraje të lidhur para noterit
- Faturën Tatimore për periudhën e marrjes së mjeteve me qera
- Çertifikatat e Pronësisë
- Lejet e qarkullimit.
- Çertifikatë e kontrollit Teknik
- Taksat e paguara.
- Siguracionet

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga Operatorët Ekonomik të Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës nr. 10 të DST-ve.

Ne rast se operatori shpallet fitues, perpara lidhjes se kontrates duhet te dorezoj dokumentat provuese per vetedekarimet qe ka bere ne formularin permbledhes te vetedeklarimit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë te pakten 3 Automjete te Blinduara, me nivel blindimi minimalisht BR3, ose sipas standarteve europiane EN 1063, EN 1522, EN 1523 ose me standarte te ngjashme me to, te te njejtit nivel blindimi, ne zbatim te Udhezimit Nr.130 datë 05.03.2018 te Ministrit te Brendshem “Per Funkcionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike”, botuar ne Fletoren Zyrtare ne date 09.03.2018, në emër të shoqërisë ose në rastin kur janë në emër të administratorit, apo të marra me qera nga një person juridik apo fizik tjetër.

Për automjetet **në pronësi** duhet të paraqiten:

- *Autorizim per perdorimin e Autoblindit, leshuar nga Drejtoria e Pergjitheshme e Policise*
- *Çertifikatat e Pronësisë*
- *Taksat e paguara.*

Për automjetet **me qera** duhet të paraqiten:

- *Kontratë qeraje të lidhur para noterit per marrjen me qira te mjetit*
- *Autorizim per perdorimin e Autoblindit, ne emer te qiramarresit, leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise*
- *Çertifikatat e Pronësisë*
- *Taksat e paguara.*

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 10 te DST-ve.

Ne rast se operatori shpallet fitues, perpara lidhjes se kontrates duhet te dorezoj dokumentat provuese per vetedekarimet qe ka bere ne formularin permbledhes te vetedeklarimit

Argumentimi: Ne zbatim te Udhezimit ne Nr. 130, datë 5.3.2018 “PËR FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT PRIVAT TË SIGURISË FIZIKE”, Kreu VI Ruajtja Dhe Sigurimi I Objekteve Të Sektorit Bankar, Sigurimi Dhe Shoqërimi I Vlerave Monetare, Materiale Dhe Sendeve Të Çmuara Gjatë Transportit, germa B. Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare, materiale dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, pika 3. Subjektet SHPSF-ve të pajisura me licencë të nënkategorisë 1.3.B, që transportojnë vlera monetare, materiale dhe sende të çmuara, përdorin kurdoherë automjete të blinduara që plotësojnë kushtet minimale teknike dhe të sigurisë, **sipas standardeve evropiane EN 1063, EN 1522, EN 1523 ose me standarde të ngjashme me këto**, vërtetuar me certifikatën përkatëse të prodhuesit, i projektuar për transportin e vlerave monetare, sendeve të çmuara, si dhe për transportin e punonjësve të SHPSF-së dhe germa C. Kategorizimi i automjeteve të blinduara

dhe shoqëruese pika 1 (a) Kategori A: Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, me vlerë deri në 10.000.000 lekë realizohet me:

a) Një automjet i blinduar me pjesë të ndarë të vendit të transportit të vlerave nga kabina e drejtuesit të mjetit i nivelit BR-3 (me frëngji për hapje zjarri me armë):

- Niveli i blindimit të automjetit BR-3;

- Pjesa ku vendosen mbajtësit e vlerave monetare të jetë pa xham në faqet anësore dhe të pasme të mjetit.

Duke qene se ne Udhëzimin e sipercituar kreu VI, germa B, pika 3 percaktohen si te pranueshme automjete te blinduara sipas standarteve europiane EN 1063, EN 1522, EN 1523 ose me standarde të ngjashme me këto, autoriteti kontraktor ne mbeshtetje te ketij percaktimi zgjeron pranueshmerine per plotesimin e kesaj kerkese duke pranuar te gjitha standartet e percaktuar europiane ne permbushje te nivelit te nevojshem te sigurise.

Gjithashtu, ky ndryshim synon te permbush edhe qellimin e vete ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2 ku percaktohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

2.3.8 Me qëllim realizimin e shërbimit në përputhje me Udhëzimin nr.130 datë 5.3.2018 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike” të Ministrit të Brendshëm dhe parandalimin e veprimeve kriminale, OE duhet të disponojë jo më pak se 5 dedektorë dore elektronike, jo më pak se 5 spray neuroparalizues, jo më pak se 5 radio komunikimi dhe jo më pak se 5 copë jelek antiplumb.

Në rastet kur pajisjet janë blerë brenda vendit operatori duhet të paraqesë:

– *Faturë Tatimore e Shitjes e firmosur nga të dyja palët dhe e vulosur nga shitësi;*

Në rastet kur këto kapacitete janë blerë jashtë vendit operatori duhet të paraqesë:

– *Deklaratën e zhdoganimit nëpërmjet së cilës vërtetohet zhdoganimi i paisjeve;*

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatorete Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 10 te DST-ve.

Ne rast se operatori shpallet fitues, perpara lidhjes se kontrates duhet te dorezoj dokumentat provuese per vetedekarimet qe ka bere ne formularin permbledhes te vetedekarimit.

Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën e verifikimit të pajisjeve dhe në rast se konstaton se operatori ekonomik nuk disponon realisht pajisjet, autoriteti përveç se do ta skualifikojë, por do të kryejë denoncim dhe në APP për qëllim të nenit 13 të LPP-së.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kriteri duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve pjesëmarrës në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në të kundërt përbën kusht s'kualifikimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Në ligjin nr. **75/2014** “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, neni 27, pika “c”, neni 32 pika 1 dhe neni 37 pika 1 e këtij ligji parashikon se:

27/c “...punonjësi i shërbimit ka përgjegjësi të mbajë, sipas rregullores, armatimin personal e pajisjet e shërbimit, të përdorë uniformën, shënjat dhe simbolet e SHPSF-së, vetëm gjatë kryerjes së detyrës si dhe të përdorë armën sipas legjislacionit në fuqi.”

32/1 “Subjektet e licencuara janë të detyruara të përdorin mjete dhe pajisje elektronike në veprimtarinë e sigurisë fizike”

37/1 “Subjekti i SHPSF-së, për realizimin e detyrës, vë në dispozicion të punonjësve të shërbimit mjete e pajisje shërbimi”

Njësia e Prokurimit duke patur parasysh numrin e objekteve në të cilat do të ofrohet shërbimi me roje dhe rëndësinë që ka ruajtja e këtyre objekteve (personeli, vlerat monetare në to etj) gjykoj se pajisja e rojeve me dedektor dore elektronik, spray neuroparalizues, radio dore dhe Jelek Antiplumb është e nevojshme për parandalimin e veprimeve kriminale që mund të kryhen (ku nga përvojat e kaluara, kemi patur shumë ndodhi të tilla fatkeqësisht), për këtë arsye vendosi t'u kërkojë Operatorëve Ekonomik të disponojnë pajisje e kërkuara, kërkesë e cila është vendosur në përputhje të plotë me Kreun VII “Uniforma, Mjetet, Pajisjet e Shërbimit, Dokumenti i Identifikimit të Punonjësit të SHPSF-së”, gërma B “Mjetet dhe pajisjet e shërbimit” pika 3, përcaktohet se:3. Shoqëria private e sigurisë fizike, për realizimin e detyrës, në varësi me specifikat e shërbimit pajis punonjësit me:

- a) armatim personal, në përputhje me parashikimet e ligjit “Për armët”;*
- b) pistoleta elektrike;*
- c) bodygard spray;*
- d) jelek antiplumb;*
- e) hekura lidhës;*
- f) shkop gome;*
- g) elektrik dore;*
- h) radio ndërlidhjeje;*
- i) detektor dore;*
- j) maskë gazi;*
- k) dylbi;*

- l) *helmetë;*
- m) *rrip multifunksional.*

Njësia vendosi të kërkoj pajisjet e mësipërme sepse ato kane lidhje të ngushtë me objektin e kontratës dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës. Njësia vlerëson se pa këto pajisje një operator ekonomik nuk mund të realizoj shërbimin e parashikuar në këtë prokurim.

2.3.9 Operatori duhet të disponojë jo më pak se 1 (një) Sistem Radiokomunikimi të vërtetuar me fatura tatimore, pagesat përkatëse dhe deklarin e faturave në sistemin elektronik të tatimeve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Referuar numrit të qendrave të kontrollit të kërkuar si dhe referuar specifikës së ligjit për funksionimin e Qendrës së Kontrollit e cila duhet të jetë e pajisur me sistem ndërlidhjes e komunikimit është domosdoshmëri, duke qënë se çdo Operator Ekonomik mund t’i sigurojë, për këtë arsye Njësia e Prokurimit vendosi ti përfshijë si kriteret për të vetmen arsye, atë në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesë e cila është vendosur në përputhje të plotë me parashikimet e Kreun VII “*Uniforma, Mjetet, Pajisjet e Shërbimit, Dokumenti i Identifikimit të Punonjësit të SHPSF-së*”, gërma D “*Qendra e kontrollit*” pika 1 dhe 2, në të cilin përcaktohet se:

“2. *Qendra e Kontrollit pajiset me sistem ndërlidhës telefonik (mobile e fiks) dhe radiokomunikim, të cilat bëjnë të mundur marrjen në kohë të sinjaleve të alarmit dhe sigurimin e pandërprerë të komunikimit pranë çdo objekti në ruajtje.*

3. *Serveri bazë duhet të jetë i pajisur me qendrën multifunksionale ku të ketë sistemin bazë të marrjes, përpunimit dhe ruajtjes së sinjaleve të alarmit, të marrjes dhe administrimit të të dhënave, në të gjitha rrugët e sigurimit, radio, GPS-GPRS, GPRS, ADSL dhe ruajtjes së sinjalit video.*”

si dhe gërma E “*Organizimi i shërbimit në Qendrën e Kontrollit*” pika 8, në të cilin përcaktohet:

“3. *Qendra e Kontrollit realizon monitorimin me anë të sistemit të kamerave të cilësisë së lartë, gjurmimin dhe lokalizimin në kohë reale të automjeteve nëpërmjet sistemit GPS/GPRS, si dhe marrjen dhe verifikimin e sinjaleve të alarmit (sinjal grabitje, sinjal zjarri) nëpërmjet komunikimit me pajisjet në përdorim:*

- *telefon celular (GSM);*
- *telefon fiks (Kontakt ID);*
- *radio.*”

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

- Grupi i shoqërimit të vlerave monetare të SHPRSF-se duhet të jete i perbere nga punonjes të certifikuar në Nënkatëgorinë 1.3.B sipas parashikimeve të Kreut VI pika C për shoqërimin e vlerave monetare. Keta punonjes duhet të jene të pajisur me mjete mbrojtëse, uniforme dhe dokument identifikimi sic parashikohet në Ligjin Nr.75/2014 “Për Sherbimin Privat të Sigurisë Fizike ” dhe Udhëzimin Nr. 130 datë 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme botuar në Fletoren Zyrtare date 09.03.2018 .
- Ky Grup duhet të shoqërojë vlerat monetare që i janë besuar dhe të sigurojë jetën e personelit gjatë transportit të vlerave monetare. Detyra e tij funksionale është Shoqërimi i sigurte i punonjesve (arketareve) nga Filialet e FSHU/ OSHEE Group sh.a drejt filialeve të Bankave respektive sipas zgjedhjes së FSHU/ OSHEE Group sh.a.
- Punonjësi i OSHEE sh.a (arketari/rja) duhet të shoqërohet nga roje të armatosura.
- Për transportin e vlerave monetare Ofertuesi duhet të pajisë punonjësit e shërbimit me arme sipas përcaktimeve ligjore të Ligjit Nr.75 /2014 “Për Sherbimin Privat të Sigurisë Fizike ”.
- Shoqërimi duhet të kryhet nga një mjet i Operatorit Ekonomik. Mjeti duhet të jete i blinduar, i loguar në gjendje të rregullt teknike dhe dokumentare që të kryejë shoqërimin e vlerave monetare. Automjetet që transportojnë vlera monetare ndalohet që të vendosin në to dhe të përdorin pajisje zanore alarmi apo sisteme pamore me dritë vezulluese.
- Shoqërimi i vlerave monetare do të kryhet një ose dy herë në ditë sipas vendndodhjes së Arkes apo KNK-ve të përcaktuara në Tabelën e publikuar nga Autoriteti Kontraktor sipas shpërndarjes së objekteve dhe grafikut të ekzekutimit të përcaktuar në tabelën e Shtojcës Nr.11 dhe në zbatim të plote të instruksioneve të personave përgjegjës të FSHU/OSHEE sh.a, me grafik shërbimi përkatës nga dita e hënë - shtunë.

Koha orare e shoqerimit te vlerave monetare do te jete :

- Turni i pare do te kryhet nga Ora 14.00 - 16.00
- Turni i dyte do te kryhet nga Ora 19:00 - 20:50
- Shoqërimi duhet të kryhet me mjetet e shoqërisë së shoqërimit, mjeti duhet të jetë i blinduar, i loguar, në gjendje të rregullt teknike dhe dokumentare për kryerjen e shërbimit ruajtje dhe shoqërim të vlerave monetare.

Ofruesi i Shërbimit SHPRSF duhet te plotesoje kerkesat e meposhtme :

- Te jete i certifikuar nga autoritetet kompetente per ushtrimin e funksionit.
- Te reflektoje nje sjellje korrekte dhe te respektueshme.
- Gjate gjithë kohës së shërbimit punonjësi i Shoqërisë SHPRSF duhet te respektojë rregullat e brendshme të FSHU/OSHEE sh.a.
- Të kërkojë nga punonjësit të zbatojnë rregullat e brendshme të Objektit.
- Punonjësi i Shërbimit duhet te jete i afte te reagoje dhe te veproje gjithmone ne perputhje me instruksionet e personave pergjegjes te percaktuar nga FSHU/OSHEE sh.a.
- Punonjësit e Shoqërisë SHPRSF qe kryejne shoqërimin e vlerave monetare duhet te jene te pajisur me armatim sipas ligjeve ne fuqi dhe ne zbatim te Udhezimit te Ministrit te Brendshem Nr.130 datë 05.03.2018 “Per Funksionimin e Shërbimit Privat te Sigurise Fizike” si dhe me mjete speciale per perballimin e situatave nga sulme te mundshme me qellim grabitjen e vlerave monetare (Radio , Shkop gome , hekura lidhes etj).
- Shoqëria private per te siguruar shoqërimin e vlerave monetare dhe për realizimin me korrektesi te detyrës duhet te vere në dispozicion të punonjësve armatim dhe pajisje të shërbimit; armatim personal sipas ligjit per armet, jelek antiplumb, hekura lidhes, shkop gome, radio nderlidhje dhe GPS.
- Të gjithë punonjësit e shërbimit “Per Funksionimin e Shërbimit Privat te Sigurise Fizike”, duhet te mbajne dokumentin e identifikimit në vend të dukshëm dhe vetëm gjatë kryerjes së detyrës ata detyrohen ta paraqesin atë sa herë u kërkohet për identifikim nga strukturat e policisë apo organet e tjera ligjzbatuese.
- Të gjithë punonjësit e ofruesit të shërbimit të kërkuar duhet të jenë të pajisur me uniformen operacionale me elementet perberes dhe të gjitha materialet e nevojshme logjistike sipas Ligjit Nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” të publikuar ne Fletoren Zyrtare date 08.08.2014 dhe Udhezimit Nr.130 datë 05.03.2018 te Ministrit te Brendshem “Per Funksionimin e Shërbimit Privat te Sigurise Fizike”, publikuar ne Fletoren Zyrtare date 09.03.2018.
- Ne zbatim te Nenit 27 pika c e Ligjit Nr.75/2014 “Per Shërbimin Privat te Sigurise Fizike”, punonjësi i shërbimit ka pergjegjesi te mbaje sipas rregullores armatimin personal dhe pajisjet e shërbimit, te perdore uniformen, shenjat dhe simbolet e SHPRSF-se vetem gjate kryerjes se detyres si dhe te perdore armen sipas legjislacionit ne fuqi.
- Ne lidhje me perdorimin e forces, punonjësit e shërbimit duhet te zbatojne Nenin 33 te Ligjit Nr.75/14 “Per Shërbimin Privat te Sigurise Fizike” ku percaktohet qarte se: *“Punonjësi i Shërbimit i SHPSF-së përdor forcën fizike dhe pajisjet e mjetet e tjera, të dhëna për përmbushjen e detyrës, vetëm kur kjo*

është e nevojshme dhe nëse masat e tjera nuk kanë dhënë rezultat, në përputhje me kriteret e përshkallëzimit të saj. Punonjësi i shërbimit përshkallëzon nivelin e nevojshëm të përdorimit të forcës, duke filluar nga bindja me fjalë, shtrëngimi fizik, deri te shkopi i gomës. Punonjësi i shërbimit duhet të paralajmërojë se do të përdorë forcën para përdorimit të saj”.

- Drejtuesi Teknik i SHPSF-së është drejtuesi më i lartë teknik i shoqërisë dhe do të përgjigjet për organizimin, drejtimin, kontrollin e kryerjes së shërbimit për shoqërimin dhe sigurimin e vlerave monetare gjatë transportit. Ai duhet të përcaktojë rregullat e funksionimit të SHPSF-së në lidhje me ruajtjen e objektit, personit apo shoqërimin e vlerave monetare në lëvizje, si dhe të përpilojë plandislokimin për çdo objekt së bashku me skemat e ruajtjes dhe plane të veçanta ruajtje për situata emergjente. Ai do të jete përgjegjës për informimin në kohë të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe do të sigurojë bashkëpunimin e vazhdueshëm me to për probleme që lidhen me sigurinë e objektit në ruajtje; Drejtuesi Teknik planifikon shërbimet për shoqërimin e vlerave monetare në lëvizje.
- Serveri bazë të jetë i pajisur me qendrën multifunksionale ku të ketë sistemin bazë të marrjes, përpunimit dhe ruajtjes së sinjaleve të alarmit, të marrjes dhe administrimit të të dhënave, në të gjitha rrugët e sigurimit, radio, GPS-GPRS, GPRS, ADSL.
- Qendra e Kontrollit duhet të realizojë monitorimin me anë të sistemit të kamerave të cilësisë së lartë, gjurmimin dhe lokalizimi në kohë reale të automjeteve nëpërmjet sistemit GPS/GPRS, si dhe :
 - a) nëpërmjet telefonit celular (GSM);
 - b) nëpërmjet telefonit fiks (Contact ID);
 - c) (radio).

Argumentimi: Ligjit Nr.75 /2014 ”Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike ”, Udhezimii Ministrit te Brendshem Nr.130 datë 05.03.2018 “Per Funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike”.

NJËSIA E PROKURIMIT